



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores MF – NR.02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 duke u bazuar edhe në Procesverbalin e Komisionit për regjistrimin dhe vlerësimin e aseteve Nr.6-400-8655 datës 09.03.2021, Kryetari i Komunës, nxjerr

VENDIM
PËR SHITJEN E ASETEVE

Neni 1

Me këtë Vendim në procedurë të ankandit publik sipas Procesverbalit të Komisionit për regjistrimin dhe vlerësimin e aseteve Nr.6-400-8655 datës 09.03.2021, do të bëhet shitja e aseteve – librave shkollor jashtë përdorimit sipas aneksit të bashkëngjitur që përmban regjistrin e aseteve të vlerësuara.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Prokurim dhe Drejtorati për Arsim i Komunës së Lipjanit.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Arsim.

1Nr.400-8655
Lipjan, më 09.03.2021

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti